



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 88 dt.30.07.1996

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës, dt.30.07.1996, pasi u shqyrtua relacioni i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Propozim për kalim në fond banese dhe pajisje me autorizim”, në zbatim të Ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992, neni.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, të V.K.M. Nr.49, dt.29.01.1993 ”Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, të V.K.M. Nr.530, dt.17.10.1994 si dhe V.K.M. Nr.379, dt.26.06.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në V.K.M. Nr.81, dt.28.02.1994” për kthimin në fond banese të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit pika.3,

VENDOSI

1. Të miratojë kalimin në fond banese provizor të objektit (Aneks dhe magazinë e Institutit të Studimit të Tokave në Laprakë), pa të drejtë privatizimi për familjet që jetojnë aty dhe t’i rekomandohet Drejtorisë së Urbanistikës të bëjë studimin për mundësinë e ndërtimit të godinave shumkatëshe në këtë zonë.
2. Deri sa të merrret vendimi përfundimtar i gjyqjit për pronën e ish pronarit të truallit Rexhep Topi të mos vendoset për këtë ish zyrë fronti e lagjes Nr.47 që ndodhet në rrugën “Ferid Xhajko” pallati 63/6.

3. Të kalojë në fond banese objektin ish depo e Ndërmarrjes Konserva Prodhim Makaronash dhe të pajisi me autorizim definitiv për (1+1) për këtë ambient qytetarin Sabri Xhaja.
4. Të miratojë kalimin në fond banese objektin godinë tre katëshe (Ish zyrat e N.N.Ushtarake)që ndodhet në rrugën “M.Keta”.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Seksioni i Strehimit të Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA